



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 456/7 Prot.

Tiranë, më 04.11.2016

V E N D I M
Nr. 112, datë 04.11.2016

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 456/1 prot., datë 29.06.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nenit 185, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Këshillin e Qarkut Kukës, për rastin e nëpunësit *****,

VËREJ SE :

Në vijim të informacionit të përcjellë nëpërmjet kërkesës së protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 456 prot. datë 23.06.2016, të punonjësit ***** , në lidhje me lirimin e tij nga shërbimi civil pranë Këshillit të Qarkut Kukës, në kushtet kur lindën dyshime të arsyeshme për mundësinë e cenimit të të drejtave të nëpunësit civil, me aktin nr. 456/1 prot, datë 29.06.2016, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka urdhëruar verifikimin e ligjshmërisë të aktit administrativ nr. 20, datë 01.04.2016, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Kukës, "Për lirimin nga detyra" të nëpunësit *****.

Në zbatim të urdhrin të sipërpërmendur, nëpërmjet shkresës nr. 456/2, datë 29.06.2016, "Njoftim mbi fillimin e verifikimit", është vënë në dijeni Këshilli i Qarkut Kukës, për fillimin e verifikimit dhe njëkohësisht është kërkuar dhe dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e këtij procesi. Këshilli i Qarkut Kukës, në përgjigjen e dhënë me shkresën nr. 574/1, datë 12.07.2016, ka përcjellë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dokumentacionin përkatës në lidhje me procedurën e kryer për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të nëpunësit ***** , për shkak të ristrukturimit të realizuar në këtë institucion.

Bazuar në sa më sipër, u krye hetimi i plotë administrativ, u administrua dokumentacioni i nevojshëm për trajtimin e rastit dhe më pas u vlerësua ligjshmëria e veprimeve administrative të

kryera nga njësia përgjegjëse, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për shkak ristrukturimi, të punonjësit ******, në pozicionin e punës “Përgjegjës i ZAMT”, pranë Këshillit të Qarkut Kukës.

Sipas akteve administrative që bëjnë të mundur verifikimin e statusit të punësimit për punonjësin në fjalë, rezulton se ai ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Kukës në datën 01.04.2008 në pozicionin “*Specialist i DAMT-së*”. Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), e ka gjetur në këtë pozicion pune prandaj, në bazë të nenit 67, pika 4, të ligjit në fjalë, njësia përgjegjëse me aktin nr. 29, datë 23.07.2014, e ka deklaruar atë “*nëpunës të shërbimit civil në kategorinë ekzekutive*” në pozicionin “*Specialist i ZAMT-së Kukës pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”.

Me aktin nr. 19, datë 30.07.2015 i është rikonfirmuar statusi *nëpunës i shërbimit civil në kategorinë ekzekutive*, në pozicionin “*Specialist i ZAMT-së Kukës*”. Në vijim, me Urdhrin nr. 7/13, datë 01.02.2016, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Kukës, është liruar nga detyra në pozicionin *Specialist i Mbrojtjes së Tokës* dhe është emëruar përkohësisht (*komanduar*), në pozicionin “*Përgjegjës i ZAMT Kukës*”, pranë Këshillit të Qarkut Kukës, deri në plotësimin e këtij pozicioni sipas procedurave të pranimit në shërbimin civil.

Bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, Këshilli i Qarkut Kukës me Vendimin nr. 2, datë 27.01.2016, ka miratuar strukturën e administratës, nivelin e pagave dhe masën e shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Kukës. Sipas strukturës së miratuar me vendimin në fjalë, rezulton se Këshilli i Qarkut Kukës, ka pësuar shkurtim të numrit të përgjithshëm të vendeve të punës. Konkretisht nga **29** pozicione pune që kishte struktura e mëparshme¹ (*ku përfshihen pozicionet e punës në Administratën e KQ-së dhe funksionet e deleguara*), në **15** pozicione pune në strukturën e re (*ku përfshihen gjithashtu, pozicionet e punës në Administratën e KQ-së dhe funksionet e deleguara*). Nisur nga ky fakt, arrihet në përfundimin se institucioni është përfshirë në procesin e ristrukturimit, pasi rezulton se ka shkurtim real të numrit të pozicioneve të punës dhe riorganizim të tyre që konsiston në riorganizimin, konceptimin e ri të pozicioneve të punës dhe kërkesave të posaçme të këtyre pozicioneve, shkrirjen/bashkimin apo ndarjen e tyre.

Nga krahasimi i strukturës së mëparshme dhe asaj aktuale konstatohet se Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) (*si funksione të deleguara*) nuk ka pësuar ndryshime përsa i përket numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës të përfshira në këtë Drejtori, që në total janë përsëri, **5** pozicione pune. I vetmi ndryshim që konstatohet ka të bëjë me kërkesat e veçanta të këtij pozicioni, konkretisht në lidhje me kriterin arsimor të kërkuar (*fushën e studimeve*) që në strukturën e mëparshme përcaktohej “*agronom, gjeodet, gjeograf dhe ekonomist*”, ndërkohë që sipas strukturës aktuale kriteri arsimor (fusha e studimeve) është përcaktuar “*agronom, gjeodet, ekonomist*”.

Kryetari i Këshillit të Qarkut Kukës, bazuar në Vendimin nr. 2, datë 27.01.2016 të Këshillit të Qarkut Kukës “*Për miratimin e strukturës së Administratës së Këshillit të Qarkut Kukës*”, ligjin

¹ Miratuar me Vendimin nr. 2, datë 28.01.2015, ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 12.10.2015 të Këshillit të Qarkut Kukës.

nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), Vendimin nr. 171, dt. 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullim dhe lirim nga shërbimi civil”, Memon informuese mbi procesin e ristrukturimit me nr. 1373 prot, datë 30.12.2015, si dhe Vendimin nr 03, datë 04.02.2016 “Propozim për lirim nga detyra të nëpunësve që preken nga ristrukturimi i administratës së Këshillit të Qarkut Kukës”, ka njoftuar punonjësin ***** për përfshirjen në këtë proces ristrukturimi, me shkresën nr. 134 prot., datë 05.02.2016 “Njoftim mbi zgjidhjen e marrëdhënieve të punës” dhe në vijim, me Urdhrin nr.20, datë 01.04.2016, “Për lirim nga detyra”, ka urdhëruar lirimin e ***** nga detyra e Përgjegjësit të ZAMT-së Kukës pranë Këshillit të Qarkut Kukës “për shkak të mospërputhjes së arsimit me pozicionin e punës”.

Në rastin konkret, konstatohet se procedura e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për ata punonjës pjesë e shërbimit civil, që u është shkurtuar, apo ristrukturuar pozicioni i punës, është kryer në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Kreun II dhe III, të Vendimit nr. 171 dt. 26.3.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

Sipas dokumentacionit të administruar, rezulton se është ngritur Komisioni i Ristrukturimit në Këshillin e Qarkut Kukës, i cili ka shqyrtuar mundësitë e sistemimit, për secilin prej nëpunësve civilë, në vendet e lira të mbetura apo riorganizuara dhe më pas ka bërë propozimin përkatës për njësinë përgjegjëse, për transferimin e nëpunësve në një vend pune ku përmbushen kërkesat specifike. Kjo veprimtari është materializuar në aktet si, 1) Urdhri për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit; 2) materialet që dokumentojnë mënyrën se si ka funksionuar ky komision dhe propozimet e tij, në lidhje me transferimet, riemërimet dhe lirimet nga shërbimi civil, të punonjësve të institucionit, të cilëve u është shkurtuar, apo ristrukturuar pozicioni i punës; 3) aktet që dokumentojnë vendimmarrjen përfundimtare për miratimin, apo mosmiratimin e propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit, e akte të tjera në lidhje me këtë aspekt.

Duke krahasuar strukturën e mëparshme të institucionit, me strukturën e re të miratuar, konstatohet se, pozicioni i punës “Përgjegjës i ZAMT-së Kukës”, ku punonte efektivisht ky punonjës në momentin e ristrukturimit, si edhe pozicioni i mëparshëm, “Specialist i ZAMT-së”, ku ai punonte në momentin e fillimit të efekteve të ligjit aktual për nëpunësin civil, nuk janë shkurtuar. Si më sipër përmendur, i vetmi ndryshim që konstatohet të ketë ndodhur ka të bëjë me kriterin arsimor të kërkuar (fushën e studimeve) që në strukturën e mëparshme (miratuar me vendimin nr. 2, datë 28.01.2015, ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 12.10.2015 të Këshillit të Qarkut Kukës) përcaktohej “agronom, gjeodet, gjeograf dhe ekonomist”, ndërkohë që sipas strukturës aktuale kriteri arsimor (fusha e studimeve) është përcaktuar “agronom, gjeodet, ekonomist”. Punonjësi ***** rezulton se ka ndjekur studimet e larta universitare në Fakultetin Gjeologji-Miniera dhe në përfundim të tyre i është akorduar titulli “Inxhinier Markshajder” (fusha e studimeve markshederi).

Në këtë rast, detyra e Komisionit të Ristrukturimit, duke u bazuar në rregullin e përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe në Vendimin nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*, ishte të vlerësonte ndërmjet të tjerave, nëse ekzistonte mundësia për sistemimin në vendet e lira ekzistuese dhe të propozonte transferimin e nëpunësit ***** në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori.

Në përfundim të këtij procesi administrativ, Komisioni i Ristrukturimit, duke konsideruar se arsimimi i punonjësit ***** nuk përputhet me kriterin arsimor të përcaktuar në strukturën e miratuar me Vendimin nr. 2, datë 27.01.2016 të Këshillit të Qarkut Kukës *“Për miratimin e strukturës së Administratës së Këshillit të Qarkut Kukës”* dhe nuk është gjetur asnjë mundësi për sistemimin e tij, ka paraqitur propozimin për lirim nga detyra të punonjësit *****. Mbi bazën e këtij propozimi, Kryetari i Këshillit të Qarkut Kukës ka nxjerrë urdhrin nr. 20 prot., datë 01.04.2016, për lirim nga detyra dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës të nëpunësit ***** si pasojë e ristrukturimit. Ky akt është nxjerrë duke respektuar rregullat dhe procedurën e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, dhe kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, i Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*.

Nga gjithë sa u tha më sipër, rezulton që procedura e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit është konform ligjit, pasi në tërësi, janë respektuar rregullat dhe kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*. Propozimi për lirim nga shërbimi civil është bërë në përputhje me kërkesat specifike për pozicionin e punës, sikurse janë përcaktuar në vendimin nr. 2, datë 27.01.2016 të Këshillit të Qarkut Kukës, si dhe të dhënat e nëpunësit *****. Por, konstatohet gjithashtu, se në propozimin e komisionit dhe në aktin e ndërprerjes së marrëdhënies të punës që ka miratuar këtë propozim, nuk përcaktohen të drejtat që gëzon nëpunësi civil sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar. Njësia përgjegjëse, duhet të ishte kujdesur që, në rastin e pamundësisë së sistemimit të punonjësit ***** të vendosej përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, duke i njohur atij, të drejtat e plota që parashikon ligji nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Konkretisht, përveç mundësisë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohet në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tij, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për nëpunësin ***** njësia përgjegjëse duhet të kishte përcaktuar dhe dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil” ,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, të plotësojë aktin nr. 20, dt. 01.04.2016 për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësit *****, me të drejtat që parashikohen në pikën 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohet në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tij, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht.
2. Këshilli i Qarkut Kukës, të zbatojë vendimin brenda **15** ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin, për zbatimin e vendimit.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Këshilli i Qarkut Kukës dhe kërkuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA